



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1188 / Prot

2

Datë 16/5 2022

VENDIM

Nr. 16, Datë 11.05.2022

PËR

**“MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE SHITESË TË STUDENTËVE PËR FITUES
BURSE, REDUKTIM / PËRJASHTIM TARIFE, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”**

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 903, datë 21.12.2016 Të këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fodi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar”, me VKM nr. 784, datë 26.12.2018; VKM nr 39, datë 23.01.2019, VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar me VKM-në nr. 698, datë 21.11.2018, nr. 779, datë 26.12.2018; VKM nr. 40, datë 23.01.2019; VKM nr. 251, datë 27.03.2020; VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”; VKM nr. 778, datë 26.12.2018 “për një ndryshim dhe shtesë në VKM-në nr. 288, datë 21.05.2018, të këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar; materialit të paraqitur nga Administratori i UT-së Bordi i Administrimit,

Vendosi:

1. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë përjashtim në masën 100 % të tarifës sipas formularit nr.1, 1/1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të dytë me kohë të plotë që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas formularit nr.2, 2/1 bashkëlidhur.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT**

3. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë përjashtim në masën 50 % të tarifës sipas formularit nr.3 bashkëlidhur.
4. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë bursë sipas formularit nr.4, bashkëlidhur.
5. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në buxhetin e vitit 2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij për vitin akademik 2021-2022.
7. Ky vendim t'i njoftohet AKFAL-it, MASR-së, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit të Tiranës për vitin 2022, sipas pasqyrës nr.5 bashkëlidhur.

